

Politika e Anëtarësimit në ARTPOLIS

ARTPOLIS-i është organizatë joqeveritare që vepron në Kosovë dhe promovon kulturën, artin dhe bashkëjetesën multietnike përmes dialogut shoqëror dhe aplikimit të teatrit si mjet për të promovuar zhvillimin social dhe kulturor. E themeluar më 2004, misioni i saj kryesor është të ndikojë në zhvillimin e një shoqërie e cila respekton vlerat kulturore të artit, kulturës dhe diversitetit shoqëror. Përdorimi i artit dhe kulturës si mjet për të realizuar objektivat e saj e bën organizatën ARTPOLIS më të veçantë, më afër qytetarëve dhe më lehtë për ta kuptuar.

ARTPOLIS-i ka identitet dhe profil të qartë në spektrin e shoqërisë civile si organizatë e cila me punën e saj në mënyrë sistematike adreson çështje të të drejtave të njeriut, siç është barazia gjinore, fuqizimi i gruas dhe feminizmi si vlera shoqërore dhe të drejta të njeriut.

Duke qenë një organizatë gjithëpërfshirëse e njerëzve të vullnetit të mirë që janë të interesuar që të kontribuojnë në promovimin e të drejtave të njeriut dhe arritjen e barazisë gjinore, në përmirësimin e kulturës dhe shoqërisë në Kosovë, ARTPOLIS, shpall të hapur mundësinë e anëtarësimit për të gjithë individët që ndajnë vlerat dhe vizionin që organizata promovon.

Barazia gjinore, mbrojtja universale e të drejtave të njeriut si në nivelin individual ashtu edhe atë grupor/kolektiv janë disa prej vlerave thelbësore, të cilat aplikantët për anëtarësim duhet t'i kenë.

ARTPOLIS-i sheh forcë në diversitet dhe mirëpret anëtarët e rinj të të gjitha prejardhjeve dhe besimeve, por vlera dhe respekti për çdo qenie njerëzore duhet të miratohet nga secili aplikant përpara se ai/ajo të konsiderohet për anëtarësim.

Kriteret për anëtarësim:

-  Deri në ditën e aplikimit të keni arritur moshën 16 vjeçare;
-  Vullnetarisht të aplikoni për anëtarësim;
-  Të keni dëshirë dhe vullnet të kontribuoni në promovimin e të drejtave të njeriut;
-  Të keni dëshirë dhe vullnet të kontribuoni në arritjen e barazisë gjinore;
-  Të keni dëshirë dhe vullnet të angazhoheni në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës, pa dallime;
-  Të jeni i/e gatshëm/me të kontribuoni në promovimin e artit dhe kulturës (me apo pa kompensim);
-  Të jeni i/e pastër ligjërisht dhe të mos keni vepra penale;
-  Nëse jeni i/e punësuar, apo thjesht doni të kontribuoni në përkrahjen e punës së ARTPOLIS, tarifa vjetore e anëtarësimit është 10 EUR. Edhe pse, kjo pagesë nuk është obligative, do ta çmonim shumë kontributin tuaj.

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Anëtarësimit:

Anëtarësimi juaj në ARTPOLIS, padyshim se bartë në vete edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e veta, si më poshtë:

-  Secili/a anëtar/e, që është pranuar si Anëtar/e i/e ARTPOLIS-it, ka të drejtën e votës në Kuvendin Vjetor të Anëtarësisë;
-  Ai/Ajo ka të drejtë të propozojë dhe të propozohet për pozicionet e parashikuara në organizatën dhe strukturat e ARTPOLIS-it dhe të gjitha aktivitetet dhe takimet e tjera për anëtarët;

Politika e Anëtarësimit e Organizatës ARTPOLIS

- artpolis  Pasi të jetë anëtarësuar, personi pritët të kontribuojë aktivisht në zhvillimin e organizatës dhe aktivisht të përfshihet në aktivitete, që përfshijnë, por nuk kufizohen me: trajnime, punëtori, pjesëmarrje në shfaqje teatrale, orë letrare, diskutime të hapura (kur është e përshtatshme);
- artpolis  Anëtarët gjithashtu janë përgjegjës individualisht për të promovuar vlerat e ARTPOLIS-it, punën dhe rezultatet dhe në asnjë rrethanë nuk mund të shkojnë kundër vlerave që i promovon në publik;
- artpolis  Anëtarët do të kenë prioritet në aktivitetet e Artpolisit dhe kanë përparësi ndaj joanëtarëve, përfshirë edhe çmime më të ulëta, aty ku është e mundur, në ngjarje dhe aktivitete publike që janë të hapura gjithashtu për joanëtarët;
- artpolis  Çdo vit, në takimin e asamblesë së përgjithshme, Drejtori Ekzekutiv do t'ia propozojë Asamblesë një kalendar me data tentative dhe planin vjetor të punës dhe paraqet mundësitë për angazhimin e anëtarëve, duke iu mundësuar të kenë planifikim adekuat të pjesëmarrjes (në rastet kur anëtarët janë të punësuar diku tjetër).

Si të bëheni Anëtar/e:

Në mënyrë që të bëheni anëtar/e, ju me vullnetin tuaj të lirë duhet të aplikoni për anëtarësim përmes kanaleve të siguruara/reklamuar nga ARTPOLIS (kopje fizike në zyrën e organizatës, apo formularin online në dispozicion në uebfaqen e ARTPOLIS, apo rrjetet sociale).

Varësisht prej mënyrës që ju e përzgjedhni për të aplikuar për anëtarësim në ARTPOLIS (kopje fizike në zyrën e organizatës, apo formularin online në dispozicion në uebfaqen e ARTPOLIS, apo rrjetet sociale të saj), duhet ta keni parasysh, që krahas formularit të plotësuar **duhet të bashkëngjitjen edhe dokumentet e detyrueshme** (origjinale apo të skanuara në varësi se cili kanal përdoret për aplikim për anëtarësim), që përfshijnë:

- artpolis  Formularin e plotësuar e aplikimit me deklaratat/pohimet e kontrolluara;
- artpolis  Dëshminë e transferit për tarifën opsionale vjetore të anëtarësimit për aplikantët e punësuar.

Rishikimi i Aplikimit:

Komisioni i Rishikimit të Anëtarësimit, i emëruar nga Asambleja e ARTPOLIS në takimin vjetor, rishikon të gjitha aplikacionet për anëtarësim brenda një muaji, pasi të kenë pranuar aplikimet.

Të gjithë anëtarët potencialisht të kualifikuar që përfundojnë me sukses procesin e aplikimit dhe plotësojnë kriteret e anëtarësimit bëhen anëtarë, pas shqyrtimit/vendimit pozitiv të Komisionit të Rishikimit të Anëtarësimit. Përbërja e Komisionit do të ndryshohet në secilin takim vjetor të Asamblesë së Përgjithshme. Komisioni do të raportojë para Asamblesë për ndryshimet e Anëtarësimit në periudhën paraardhëse.

Ripërtëritja e Anëtarësisë:

Kohëzgjatja e anëtarësisë në ARTPOLIS është dy-vjeçare. Aplikimi për ri-anëtarësim duhet të kompletohet brenda tre muajve nga skadimi i anëtarësimit të fundit. Për anëtarët që paguajnë, gjithashtu kërkohet dëshmi e pagesës së tarifës opsionale vjetore për anëtarësi brenda tre muajve nga skadimi.

Konfidencialiteti:

Të dhënat dhe dokumentet që ju i dërgoni kur aplikoni për anëtarësim në ARTPOLIS nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç për të verifikuar dhe aprovuar aplikimin tuaj.